

Informata të përgjithshme rreth sportit vullnetar shkollor të qytetit Thun

- Qëllimi** Sporti vullnetar shkollor ka një funksion lidhës ndërmjet mësimit të detyrueshëm të sportit dhe ofertave në klubet sportive. Qëllimi është që, mundësisht sa më shumë fëmijë përmes sportit vullnetar shkollor të frymëzohen për sportin e organizuar, kryesisht në një klub. Kurset organizohen për fillestarë, që ta njohin sa më mirë llojin e sportit / ofertën.
- Pjesëmarrja** Në kurset e sporteve vullnetare shkollore mund të marrin pjesë fëmijët e kopshtit dhe nxënësit. Shpallja e kurseve përcakton gjithashtu grupmoshat e lejuara. Gjatë një semestri mund të ndiqen më tepër kurse. Ne ju këshillojmë që fëmijët më të vegjël të ndjekin vetëm një kurs gjatë një semestri.
- Periudhat e kursit** Do të ofrohen kurse semestrale në verë (nga pushimet e pranverës deri në pushimet e vjeshtës, pa pushimin veror) dhe në dimër (nga pushimet e vjeshtës deri në pushimet e pranverës, pa pushimet e krishtilindjeve dhe pa pushimet e sportit). Këto kurse do të mbahen një herë në javë nga e hëna deri të premten pas orarit të shkollës së detyrueshme, zakonisht ndërmjet orës 16.30-19.30. Veç kësaj, më të shumtën e pushimeve shkollore gjatë ditës do të mbahen edhe kurse të tjera.
- Udhëheqja** Në lëndët e sportit/në kurse japin leksione udhëheqëse/-ësa kompetent për sport shkollor.
- Vendet e kursit** Vendet e kurseve janë të dhëna te shpalljet.
- Pagesa e kursit** Të gjitha kurset kushtojnë afërsisht 50.00 CHF për një fëmijë. Zakonisht pagesa i bëhet me para në dorë udhëheqësit të kursit në ditën e parë të kursit. Kurset e pushimeve zakonisht kushtojnë ndërmjet 10.00 CHF deri në 40.00 CHF për fëmijë. Disa kurseve të veçanta u shtohen edhe shpenzime shtesë për huazimin e pajisjeve. Këto shpenzime janë të përmendura te shpalljet.
- Për fëmijët me vendbanim në Thun, prindërit e të cilëve zotërojnë Kartën e Kaltër, ndjekja e kursit është falas. Shpenzimet e pajisjeve dhe ato materiale, patjetër që paguhen nga vetë prindërit.
- Fëmijët me banim jashtë qytetit Thun për të gjitha kurset paguajnë dyfishin e pagesës së kursit.**
- Regjistrimi** Formularët për regjistrim do tu dorëzohen shkollave fillore përmes mësuesave të klasave dhe mësuesave të kopshteve të fëmijëve. Regjistrimet për të gjitha kurset do tu kthehen prapë në afatin e caktuar mësuesave të klasave dhe mësuesave të kopshteve të fëmijëve. Për pjesëmarrje është i nevojshëm miratimi me shkrim (nënshkrimi) i prindërve. Prindërit, fëmijët e të cilëve nuk vijnë shkollën në Thun, shpalljet dhe formularët e regjistrimit do të mund ti shkarkojnë drejtpërdrejt në www.thun.ch/schulsport. Në raste të këtylla regjistrimi dorëzohet drejtpërdrejt përmes Email-it ose përmes postës në Amt für Bildung und Sport, Fachstelle Sport.
- Përgjegjësia** Qyteti Thun nuk mban përgjegjësinë për fatkeqësitë gjatë sportit vullnetar shkollor. Sigurimi në rast fatkeqësish është çështje e pjesëmarrësve.
- Informata të rëndësishme** Në të gjitha kurset numri i vendeve është i kufizuar, pa mundësi kërkesë për pjesëmarrje! Ne ju këshillojmë që, fëmijët të mos regjistrohen disa herë në të njëjtin kurs.
- Fëmijët për pjesëmarrje në kurset semestrale sipas regjistrimeve, nuk do të ftohen veç e veç dhe nuk do të marrin vërtetim regjistrimi. Në rast se nuk ndodh lidhje për kontaktim nga Zyra e specializuar e Sportit (Fachstelle Sport), atëherë regjistrimi është bërë me sukses. Lista me ndarjet përfundimtare do të mund të shihet afërsisht një javë para fillimit të kursit përmes mësuesave të klasave dhe mësuesave të kopshteve të fëmijëve dhe vlen si vërtetim regjistrimi.
- Informim** Të gjitha përshkrimet mbi kursin si dhe shpalljet edhe formularët elektronik për regjistrim gjatë periudhës së regjistrimit mund të shikohen edhe në www.thun.ch/schulsport. Amt für Bildung und Sport, Fachstelle Sport, Tel. 033 225 84 15, Email: sport@thun.ch